

Koha është TANI

Mesazh nga Grupi i Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Situata Emergjence kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Nëpërmjet kësaj letre, si organizata të shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, pjesë e grupit të punës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Situata të Emergjencës, shprehim tronditjen tonë të thellë për fenomenin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Shqipëri, dalë në dritë nëpërmjet ngjarjeve të rënda të bëra publike së fundmi. Situata në të cilën ndodhemi, duhet të konsiderohet një situatë emergjence, e cila ka nevojë për një reflektim mbarëkombëtar dhe reagim të të gjithë aktorëve për të bërë të mundur mbrojtjen efektive të çdo fëmije të rrezikuar nga dhuna apo abuzimi seksual dhe mospërsëritjen e rasteve të tilla.

Njëzëri, ne dënojmë çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi ndaj një ose më shumë fëmijëve, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijës nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Ky i fundit, në nenin 23 shprehimisht përcakton që “Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës” dhe në nenin 26 sanksionon të drejtën e fëmijëve për t’u mbrojtur nga “Trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual”.

Organizatrat firmëtare i bëjnë thirrje institucioneve publike për të analizuar sa më parë hendeqet dhe barrierat që pengojnë parandalimin dhe identifikimin e hershëm të abuzimit të fëmijëve, dhe marrjen e masave konkrete për të eliminuar këto pengesa dhe për të hartuar dhe zbatuar politika që do të mundësojnë trajtimin e rasteve të tilla me prioritet dhe në çdo rast në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Theksi duhet vendosur tek koordinimi ndër-sektorial, ku të gjithë sektorët që mundësojnë shërbime rreth fëmijës dhe familjes, të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në mbrojtje të fëmijëve, si dhe të koordinojnë përpjekjet e tyre, me qëllim parandalimin dhe identifikimin e hershëm të rasteve të abuzimit të fëmijëve. Planet dhe masat duhet të kenë një qasje bazuar në të drejtat e fëmijës dhe të sjellin në jetë angazhimet që shteti Shqiptar ka marrë duke u bërë palë e Konventave të mësipërme. Për sa më sipër, ne bëjmë thirrje për mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të cilit ligji i ka përcaktuar si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, si dhe krijimin e një komiteti teknik koordinimi për zbatimin e politikave dhe legjisllacionit për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës me pjesëmarrje nga të gjithë sektorët përkatës.

Pasi fëmija bie viktimë e abuzimit apo shfrytëzimit seksual, ai/ajo riviktimizohet sa herë që procedurat nuk janë miqësore për fëmijën dhe sa herë historia e tij/saj bëhet publike. Po ashtu, shqetësuese janë edhe vështirësitë që hasin familjet, prindërit, apo edhe motrat e vëllezërit e fëmijës së abuzuar dhe rrezikut të shtuar që i'u kanoset atyre për bullizëm, shantazh apo hakmarrje. Ngjarjet e fundit të bëra publike, na nxisin të shqetësohemi se fëmijët vazhdojnë të ripërvetohen të traumën e abuzimit për shkak të raportimeve jo-etike nga mediat, dhe proceseve jo-miqësore të procedurave penale, këtu përfshirë edhe rrjedhje të informacioneve konfidenciale nga strukturat e mbrojtjes. Në përputhje me Nenin 6, Pika 2 e Ligjit Nr. 18/2017 e cila përcakton se: “Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë

të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët”, prandaj ne iu bëjmë thirrje jo vetëm mediave, por edhe institucioneve të tjera që të jenë të kujdesshëm për të mos lejuar një riviktimizim të fëmijës në rastet kur ky i fundit është tashmë viktimë e dhunës, e çfarëdo lloj forme qoftë ajo.

Së fundmi, është e rëndësishme të ndryshojmë rrënjësisht ato norma dhe vlera sociale që tolerojnë dhe pranojnë dhunën dhe abuzimin, përfshirë dhe abuzimin seksual me fëmijët, si diçka normale, si një çeshtje private për të cilën si anëtarë komuniteti nuk kemi pse të ndërhyjmë. Një herë e përgjithmonë duhet të themi njëzëri se kundërshtimi dhe parandalimi i Dhunës dhe Abuzimit është detyrë e secilit! Është një detyrë ligjore e sanksionuar në ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës, por mbi të gjitha është një detyrë njerëzore për të reaguar sa më shpejt në ndihmë të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Çdo veprim për mbrojtje, ndihmë apo parandalim të dhunës, shfrytëzimit, trafikimit apo abuzimit të fëmijëve duhet të jetë prioritet i të gjithëve.

Koha për t’i dhënë fund abuzimit seksual të fëmijëve, për të degjuar zërin e fëmijëve, për t’i dhënë fund heshtjes, për t’a trajtuar abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve me prioritet absolut, është TANI.

Lista e organizatave firmëtare:

1. ADRA
2. Alo 116 111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë
3. Alo!Mik
4. Fondacioni “Together Albania”
5. Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS
6. Sanità di Frontiera - Health Beyond Borders
7. Save the Children
8. Shoqata Internacionale për Solidaritetin- SHIS
9. Shoqata Kombëtare Edukim për jetën - SHKEJ
10. Terre des hommes
11. Të Ndryshëm & Të Barabartë
12. UNICEF Albania
13. World Vision Albania



Time is NOW

Message from the Child Protection in Emergencies Working Group against child sexual abuse and exploitation

Through this letter, civil society and international organizations working in the field of child protection in Albania, part of the working group for the Protection of Children in Emergencies, express our deep shock at the sexual abuse and exploitation of children in Albania, coming to light through the recent severe cases made public recently. This situation should be considered as a national emergency, which needs a nationwide reflection and the reaction of all actors to enable the effective protection of any child at risk of sexual violence or abuse.

Unanimously, we condemn any form of violence, abuse, exploitation or neglect of one or more children, in accordance with the United Nations Convention on the Rights of the Child, the Council of Europe Convention on the Protection of Children against Sexual Abuse and Exploitation, the Constitution of the Republic of Albania and the Law on the Rights and Protection of the Child. The latter, in Article 23, explicitly states that "The child has the right to protection against all forms of violence, including abuse, neglect, exploitation, trafficking, hostage-taking, pornography, sexual abuse, and other forms of violence." Article 26 determines the right of children to protection against "Trafficking and any form of sexual exploitation and abuse".

The signatory organizations call on the public institutions to analyze as soon as possible the gaps and barriers that disable the prevention and early identification of child abuse, and the drafting of concrete measures to eliminate these obstacles and to design and implement policies that will enable the treatment of such cases with priority and in each case in accordance with the best interests of the child. Emphasis should be placed on cross-sectoral coordination, where all sectors that provide services to children and families understand their role and responsibility in protecting children and coordinate in order to prevent and identify cases of child abuse as early as possible. Plans and measures should have an approach based on the rights of the child and bring to life the commitments that the Albanian state has made by becoming a party to the above Conventions. Regarding the above, we call for a meeting of the National Council for the Rights and Protection of the Child, whose main task is to advise and coordinate state policies to guarantee the rights and protection of the child in all areas as well as the establishment of a technical coordination committee in charge of the implementation of the legislation and policy framework for the protection of children from all forms of violence with the participation of all relevant sectors.

After a child becomes a victim of sexual abuse or exploitation, he/she is re-victimized whenever the procedures are not child-friendly and whenever his/her story is made public. We are also concerned about all the difficulties faced by families, parents, or even the siblings of the abused child and the increased risk posed to them by bullying, intimidation, or reprisals. The latest case of child sexual abuse makes us worry that children continue to re-experience the trauma of abuse due to unethical media reports, and unfriendly criminal proceedings. In accordance with Article 6, Point 2 of Law no. 18/2017, which stipulates that: "Public and non-public authorities, as well as courts, should have as primary consideration the highest interest of the child in all actions and decisions taken in relation to children", we call on not only the media, but also other institutions to be careful not to allow a child to be re-victimized in cases where the latter is already a victim of violence, of whatever form.

Finally, it is important to radically change those norms and social values that tolerate and accept violence and abuse, including sexual abuse of children, as something normal, as a private matter for which we have no need to intervene. Once and for all we must say unanimously that opposing and preventing Violence and Abuse is everyone's duty! It is a legal duty enshrined in the law on child protection and rights, but above all it is a human duty to react as soon as possible to rescue those children that are in need of protection. Any action to protect, assist or prevent violence, exploitation, trafficking or child abuse should be a priority for all.

The time to end child sexual abuse, to listen to the voice of children, to end silence, to address the abuse and sexual exploitation of children with absolute priority, is NOW.

List of signatories:

1. ADRA
2. Alo 116 111- National Child Helpline
3. Alo!Mik
4. Fondacioni "Together Albania"
5. Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS
6. Sanità di Frontiera - Health Beyond Borders
7. Save the Children
8. Shoqata Internacionale për Solidaritetin
9. Shoqata Kombëtare Edukim për jetën - SHKEJ
10. Terre des hommes
11. Të Ndryshëm & Të Barabartë
12. UNICEF
13. World Vision Albania

